

Mbani në mend!

Historia juaj kreditore përmes raportit kreditor do të merret në konsideratë nga të gjitha institucionet kredidhënëse gjatë vlerësimit të aplikacionit tuaj për kredi.

Nëse ju si kredimarrës dështoni në kthimin me kohë të ndonjë kredie pranë ndonjë institucioni kredidhënësi, pas pasojave të drejtpërdrejta ligjore ju do të keni kufizime të merrni kredi të reja në cilindo institucion kredidhënësi në të ardhmen.

Edhe në fushën e kreditimit vlen thënia se “parashikimi më i mirë i sjelljes suaj në të ardhmen është sjellja juaj në të kaluarën”.

BQK CREDIT REPORT **RKK**

Date: 25.10.2022 Time: 09:38

Client Data

First and Last Name of Client	FLAN FYTENE	Official Address/ Place	Prishtine / Prishtine
Personal No/ Registration No	7300000	Professional Activity	
Type of Client	Resident Legal	Net Monthly Income	
Date of Birth/ Registration	15.06.2006		
Place of Birth/ Registration	Prishtine		

Personal Credits

Bank	Type of Credit	Amount	Interest Rate	Start Date	End Date	Current Balance	Outstanding Balance	Payment Status
Bank	Loan	10,000.00	10.00%	01.01.2022	31.12.2022	5,000.00	5,000.00	Up to date
Bank	Loan	5,000.00	10.00%	01.01.2021	31.12.2021	0.00	0.00	Completed

Other Credits

Bank	Type of Credit	Amount	Interest Rate	Start Date	End Date	Current Balance	Outstanding Balance	Payment Status
Bank	Loan	10,000.00	10.00%	01.01.2022	31.12.2022	5,000.00	5,000.00	Up to date
Bank	Loan	5,000.00	10.00%	01.01.2021	31.12.2021	0.00	0.00	Completed



Regjistri i Krediteve të Kosovës (RKK) është një regjistër publik i cili menaxhohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. RKK i shërben informimit kreditor të institucioneve kredidhënëse në Republikën e Kosovës.

RKK nuk e krijon informacionin kreditor por vetëm e mundëson mbledhjen dhe shpërndarjen e tij mes institucioneve kredidhënëse për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredive.

Raportimi i kredive të aprovuara dhe azhurnimi periodik i statusit të tyre nga të gjitha institucionet kredidhënëse është i obligueshëm.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi nr.33

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni: 038 222 055 Ext 427

regjstriikrediteve@bqk-kos.org

www.bqk-kos.org



Paguaj me kohë, përmirëso raportin kreditor



Çka është raporti kreditor ?

Raporti kreditor është një dokument i rëndësishëm i cili paraqet informacionin mbi kreditë tuaja. Ky informacion përdoret nga institucionet kredidhënëse në procesin e vlerësimit të aplikacionit tuaj për kredi.

Çfarë përmban raporti kreditor ?

Raporti kreditor përmban në mënyrë të strukturuar të dhënat tuaja personale, të dhënat mbi kreditë tuaja si dhe të dhënat mbi kreditë e tjera ku ju jeni garantues ose jeni të lidhur në ndonjë rol tjetër.

Informacioni i përmbajtur në raport kreditor mund të jetë pozitiv dhe negativ. Informacioni pozitiv paraqet kreditë e paguara me kohë, ndërsa informacioni negativ paraqet vonesat në kthimin e kredive.

Si përpilohet raporti kreditor ?

Informacioni i paraqitur në raportin tuaj kreditor raportohet nga institucionet kredidhënëse:

- Bankat Komerçiale
- Institucionet Mikrofinanciare dhe
- Institucionet Financiare Jobankare

Raportimi i të dhënave nga institucionet kredidhënëse bëhet në sistemin informatik "Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK)", i cili mirëmbahet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Ky raportim bëhet në pajtim me legjislacionin dhe rregullativën në fuqi.

Kush ka qasje në raportin kreditor?

Me autorizimin tuaj, zyrtarët e institucioneve kredidhënëse mund ta marrin raportin tuaj kreditor në formë të përmbledhur.

Sa janë të mbrojtura informacionet në raportin kreditor?

Informatat tuaja janë të mbrojtura dhe trajtohen si konfidenciale në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.

Për sa kohë paraqiten informacionet në raportin kreditor?

Informacioni mbi çdo kredi tuajën dhe çdo kredi tjetër ku ju jeni garantues ose jeni të lidhur në ndonjë rol tjetër do të paraqitet në raportin tuaj kreditor më së paku pesë vite prej momentit kur është bërë kthimi i plotë i saj.

A paraqet raporti kreditor të vetmin faktor që institucionet kredidhënëse e marrin në konsideratë?

Institucionet kredidhënëse në vlerësimin e aplikacionit tuaj për kredi marrin në konsideratë edhe mjaft faktorë të tjerë siç janë gjendja e juaj financiare, kapaciteti juaj për të paguar me kohë si dhe mundësitë tuaja për të siguruar kredi nëpërmes kolateralit.

Çfarë duhet të bëj nëse kam paqartësi për përmbajtjen e raportit kreditor?

Raportit tuaj kreditor do t'i bashkëngjitet një listë me përkufizime të termave të ndryshëm të përdorur në raportin kreditor.

Si mund ta marr raportin kreditor?

Raportin tuaj kreditor mund ta merrni duke plotësuar kërkesën në degën e bankës suaj, apo në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Kërkesa juaj do të përcjellet tek Regjistri i Kredive në Bankën Qendrore të Kosovës dhe pas përgatitjes, raporti juaj kreditor përcjellet tek dega e bankës suaj ku edhe mund të tërhiqet nga ju.

Për persona fizikë, raporti kreditor është falas një herë në vit, dhe nënkupton se çdo raport shtesë brenda vitit duhet të paguhet 3 €, ndërsa personat juridik për çdo raport kreditor duhet të paguajnë 3 €. Në këto raste, pagesa bëhet në cilëndo bankë komerciale prej 3 € në llogarinë e BQK: 1000700010000136 me përshkrimin Raporti Individual nga RKK.

Kërkesës suaj për raport kreditor duhet t'ia bashkëngjitni një kopje të dokumentit identifikues. Raporti juaj kreditor do të jetë i gatshëm brenda 5 ditëve.

Tani, Raportin Kreditor mund ta merrni edhe përmes internetit në web faqen: www.raportikreditor.org. Regjistrimi dhe shërbimi nëpërmjet web faqes ofrohet falas.

Çfarë duhet të bëj nëse kam vërejtje për përmbajtjen e raportit kreditor?

Për çdo të dhënë në raportin tuaj kreditor identifikohet edhe institucioni kredidhënës i cili e ka raportuar atë. Për çdo vërejtje që mund ta keni për të dhënat e përmbajtura në raport kreditor, ju mund ta kontaktoni institucionin përkatës kredidhënës.